

	KOMENTE	FO-ÇLRR-025
	ver. 1.0	faqe 1 nga 2

23.03.2015

Komente lidhur me: Raportin Konsultativ të ZRrE për SHTE 9

Çështja për komentim:

Propozimet e Raportit Konsultativ

Komentimi:

Në Raportin Konsultativ për Shqyrtimin e Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike, të publikuar nga ZRrE me 09 mars 2015, janë paraqitur propozimet për elementet e Të Hyrave Maksimale të Lejuara për KOSTT për vitin 2015.

KOSTT në Propozimin për Të Hyrat e Lejuara për vitin 2015 të dërguar në ZRrE me 29 janar 2015, ka paraqitur propozimet për të gjitha kategoritë e shpenzimeve operative, propozimin për faktorin e efikasitetit si dhe realizimin e shpenzimeve kapitale.

Nga Raporti Konsultativ i ZRrE-së del se të gjitha kategoritë e shpenzimeve operative kanë mbetur në nivelin e përcaktuar gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik të Çmimit 2013-2017. KOSTT si gjatë atij procesi, gjithashtu edhe gjatë përshtatjeve të rregullta dhe propozimit për të hyra, vazhdimisht ka paraqitur shqetësimin për nivelin e ulët të caktuar për këto shpenzime, nivel i cili vështirë se mund të mbahet ashtu siç është përcaktuar.

Për më tej, ndaj këtij niveli të përcaktuar të shpenzimeve operative është vendosur faktori i efikasitetit prej 4% i cili e shpion kompaninë në kërkim të fondeve tjera për shfrytëzim, pasi që nga tarifat e transmissioinit nuk mund të mbulohen shpenzimet e realizuara operative.

Çështja e faktorit të efikasitetit është diskutuar pothuajse në të gjitha takimet me ZRrE-në, janë shkruar fakte dhe arsyetime, mirëpo qëndrimi i ZRrE-së prapë mbetet i njëjtë duke e lënë KOSTT-in në një pozitë të pavolitshme karshi shpenzimeve operative.

Humbjet në transmision janë një tjetër rrezik financiarë për KOSTT për të cilat kompania mbanë përgjegjësi për 50% të tejkallimit të nivelit të lejuar të tyre. Ashtu siç është faktuar edhe më herët niveli i humbjeve në transmision ka arritur nivelin më të ulët teknikisht dhe zvogëlimi i mëtutjeshëm i tyre është praktikisht i pothuajse i pamundur. Në vitin 2014 përqindja e humbjeve në rrjetin e transmissioinit ishte 1.84%, pra 0.04% më e lartë se niveli i vendosur nga ZRrE. Kjo tregon se trendit të humbjeve të realizuara i ka ndërruar kahja, andaj edhe duhet të jetë parasysh se kjo mund të paraqet probleme edhe në faza afatshkurtra e sidomos në ato afatgjata.

Kostoja e lejuar e shërbimeve ndihmëse është më e vogël se sa kostoja e llogaritur nga KOSTT për vitin 2015, mirëpo duke marrë parasysh se ky është viti i parë i fillimit të realizimit të këtyre kostove atëherë nuk do të paraqiten komente të mëtutjeshme për këtë kategori, duke konsideruar se do të përshtaten në vitin që vjen pas.

KOSTT beson se shqetësimet e paraqitura përmes këtyre komenteve janë shqetësime të bazuara dhe do të gjejnë mirëkuptim.

Fundi i Dokumentit